



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 180, Datë 29.05.2023**

**MBI**

**KËRKESËN E OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (OST) SH.A., PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI PEZULLIMIN DHE RIVENDOSJEN E  
AKTIVITETIT TË TREGUT, RREGULLAVE PËR SHLYERJEN E DISBALANCIVE,  
KAPACITETIT BALANCUES DHE ENERGJISË BALANCUESE, PËR PERIUdhËN  
GJATË SË CILËS AKTIVITETET E TREGUT JANË PEZULLUAR”**

Në mbështetje të neneve 16, 19 dhe 62 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, “Kodit të Transmetimit” i miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 63, datë 11.04.2022; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.05.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1363/3 prot., datë 24.05.2023 të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi kërkesën e OST sh.a., për miratimin e rregullores “Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 106, datë 02.07.2020, vendosi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, të cilat janë në fuqi por nuk kanë të përcaktuar mënyrën e operimit të balancimit në rastet e pezullimit dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut të balancimit, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar.
- Gjithashtu ERE, me vendimin nr. 63, datë 11.04.2022, ka miratuar Kodin e Transmetimit, i cili ka hyrë në fuqi me datë 01.07.2022. Në pikën 2 të vendimit nr. 63, datë 11.04.2022, është përcaktuar se: “OST sh.a. duhet të rishikojë dhe të plotësojë të gjitha aktet që ndikohen nga ndryshimet në Kodin e Transmetimit përfshirë marrëveshjen e operimit dhe t’i përcjellë ato në ERE konform përcaktimeve ligjore në fuqi deri më 30 Prill 2023”.

- OST sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 2974 prot., datë 28.04.2023, të protokolluar në ERE me nr. 1363 prot., datë 04.05.2023, ka përcjellë kërkesën për miratim të rregullores “Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar”.
- OST sh.a. në këtë shkresë bën me dije se: *Enti Rregullator i Energjisë, me vendimin nr. 63, datë 11.04.2022, ka miratuar Kodin e Transmetimit, i cili ka hyrë në fuqi me datë 01.07.2022. Në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi, OST sh.a. duhet të rishikojë dhe të plotësojë të gjitha aktet që ndikohen nga ndryshimet në Kodin e Transmetimit dhe t'i përcjellë ato në ERE, konform përcaktimeve ligjore në fuqi. Në këto kushte OST sh.a. është angazhuar prej muajit korrik 2022 për hartimin e të gjitha dokumentave të cilët lindin si detyrim i zbatimit të Kodit të Transmetimit dhe së fundmi ka finalizuar hartimin e Rregullores “Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues, energjisë balancuese për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar si dhe kërkesave teknike që duhen plotësuar nga sistemet e komunikimeve zanore”.*
- OST sh.a. shprehet se rregullorja e përgatitur “Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar” është dërguar për shqyrtim dhe në palët e interesit dhe komentet janë shqyrtuar nga OST sh.a.
- Rregullorja e paraqitur nga OST sh.a., është e përbërë nga 16 nene të cilat përcaktojnë elementet e nevojshëm për pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar.
- Shoqata Shqiptare e Furnizueseve të Energjisë Elektrike (AAES) nëpërmjet shkresës nr. 6/1 prot., datë 09.05.2023, ka përcjellë komente lidhur me draft rregullat “Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullat për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar.
- Duke qënë se aktualisht ERE është në fazën e fillimit të procedurës së shqyrtimit të këtyre rregullave komentet e AAES si dhe komentet që do të merren nga palët e tjera të interesit do të shqyrtohen dhe trajtohen në të njëjtën kohë para vendimit përfundimtar të kësaj procedure.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e rregullave “Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar”.

2. Drejtoria Juridiek dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë OST sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**